



Prishtinë, 23 qershor 2016
Kodi i ZRRE-së: V_821_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenit 14 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, Nenit 25, Nenit 29 dhe Nenit 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 4, Nenit 6 dhe Nenit 18 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë; dhe
- Aplikacionin për licencim të aktivitetit të importit, eksportit dhe transitit të energjisë elektrike të dorëzuar në ZRRE me datë 06.04.2016 nga ndërmarrja "FUTURE ENERGY TRADING" SH.P.K, adresa: Lagjja Kalabria, A1, CII, Nr.25, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në seancën e mbajtur me datë 23 qershor 2016, nxori këtë:

VENDIM

- I. I LËSHOHET Licenca për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike ndërmarrjes "FUTURE ENERGY TRADING" SH.P.K., me numër licence ZRRE/Li_52/16 për periudhën nga data 23 qershor 2016 deri 22 qershor 2021.

Arsyetim


- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 06.04.2016 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike nga ndërmarrja "FUTURE ENERGY TRADING" SH.P.K.
- o ZRRE ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të ZRRE-së dhe kërkesave/dëshmime të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike.
- o Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.





- II. Licenca për import, eksport dhe transit të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë me kapacitet deri **100 MW**, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit "FUTURE ENERGY TRADING" SH.P.K
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe
- Departamentit Ligjor dhe të Licencimit-ZRRE